

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“Marcross” sh.p.k

Tiranë më datë 14/02/2025.

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Marcross” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Marcross” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e veprimtarisë së më poshtë

Konsulencë në zhvillimin e sistemit informatik. Krijimi dhe zhvillimi i software ose teknologjise së informacionit në shërbim të transaksioneve financiare apo proceseve të ndryshme të lidhura me to. Menaxhim i portofolave të investimit online.

Menaxhim database (të dhënash informatike) Konsulencë dhe informim mbi sistemin e sigurisë informatike.

Konsulencë mbi teknologjinë informatike në sektorin financiar dhe atë bankar në veçanti teknologji informacioni (information technology). Zgjidhje telekomunikacioni (telecommunication solutions).

Import, eksport, ndërmjetësime, agjent komisioner, tregti artikuj të ndryshëm, makineri, pajisje dhe produkte për nevojat e veta dhe për të tretë.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës, e cila është e dobishme dhe ka për qëllim përmbushjen e objektit kryesor të saj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë


Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjia nr. 16, Rruga Abaz Celkupa, Pallati nr. 944, Kati 2, Durrës, Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues i kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100 (njëqind) lekë. Kapitali dhe pronësia e kuotave nga ortaku i shoqërisë vijon si më poshtë:

- 1. Albi Abdyli**, zotërues 100% të kapitalit themeltar, e barabartë me një pjesë/kuote, me një vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.



Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilit zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **z. Albi Abdyli** lindur në Durrës më 05.03.1993, shtetas shqiptar, mbajtes e Leternjoftimit me nr. 037412988, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.



NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Ortaku Themelues

z. Albi Abdyl

Albi Abdyl 
(emër,mbiemër, nënshkrimi)